



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
SHËRBIMI I PROVËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

Rruga "Jordan Misja", Pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda

Tel. +355 4 2232 852

Nr. 668 Prot.
(lutemi referojuni në rast përgjigje)

Tiranë, më 02 . 06 .2010

Lënda: Dërgohet raporti statistikor mbi aktivitetin e Shërbimit të Provës për muajin Maj 2010

Drejtuar: **Z. BUJAR NISHANI**
MINISTËR I DREJTËSISË

TIRANË

I nderuar Z. Ministër!

Mbështetur në nenin 9, gërma gj), të VKM nr. 302, datë 25.03.2009 "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve dhe procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative"", po Ju paraqesim raportin statistikor mbi aktivitetin e Shërbimit të Provës për muajin Maj 2010.

Duke Ju uruar punë të mbarë! .

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ARBEN SEFGJINI

Konceptoi: Saimir Shyti
Datë 02.06.2010



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
SHËRBIMI I PROVËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

R A P O R T
PËR MUAJIN MAJ 2010

I nderuar Zoti Ministër,

Mbështetur në nenin 9, gërma gj), të VKM nr. 302, datë 25.03.2009 "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve dhe procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative", po Ju paraqesim raportin e veprimtarisë së Shërbimit të Provës për muajin Maj 2010.

I. Statistika

Për periudhën 01-31 Maj 2010, Shërbimi i Provës ka kryer një volum pune të madh, duke marre parasysh faktin që numri i specialistëve të Zyrave Vendore të Shërbimit të Provës është i njëjti, ndërsa numri i të dënuarve me dënime alternative që këta specialistë mbikëqyrin, si dhe kërkesat nga gjykatat dhe prokuroritë për raporte vlerësimi janë në rritje të vazhdueshme. Disa nga statistikat dhe paraqitjet që pasqyrojnë punën që ka kryer e po kryen institucioni do të jepen me anë të të dhënave si më poshtë:

Për periudhën 01 Qershor 2009 - 31 Maj 2010, statistikat rezultojnë si më poshtë:

1. Numri total i të dënuarve me dënime alternative që mbikëqyren nga Shërbimi i Provës.

Numri total i të dënuarve me dënime alternative që mbikëqyren nga Shërbimi i Provës në të gjithë vendin, për periudhën 01.06.2009 - 31.05.2010 është **1552** të dënuar, për muajin Maj 2010 (nga 01.05.2010 - 31.05.2010) është shtuar me **139** të dënuar.

- Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Tiranë mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **771** të dënuar me dënime alternative.
- Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Durrës mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **271** të dënuar me dënime alternative.
- Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Fier mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **278** të dënuar me dënime alternative.

- Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Shkodër mbikqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës 232 të dënuar me dënime alternative.

2. Numri mesatar i të dënuarve me dënime alternative që mbikqyren nga një punonjës i Shërbimit të Provës në nivel vendi dhe zyre vendore.

Aktualisht është 52 numri mesatar i të dënuarve që mbikqyren nga një punonjës në nivel vendi. E shprehur kjo për çdo zyrë vendore , është si më poshtë:

- Zyra Vendore Tiranë ka nën mbikëqyrje 77 të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Durrës ka nën mbikëqyrje 39 të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Fier ka nën mbikëqyrje 40 të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Shkodër ka nën mbikëqyrje 39 të dënuar për çdo punonjës.

Duke ju referuar statistikave, për muajin Maj 2010 kemi një shtesë prej 139 të dënuarish nën mbikqyrje gjë e cila rrit dhe ngarkesën e punës për specialistët.

3. Numri i të dënuarve për secilin lloj dënimi alternativ.

Statistikat për periudhën 01.06.2009 - 31.05.2010, për secilin lloj dënimi alternativ, janë si më poshtë:

- 1249 persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 59 i KP "pezullim i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë", shifër kjo e barabartë me 80.48 % të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.
- 22 persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 59/a i KP "qëndrim në shtëpi", shifër kjo e barabartë me 1.42 % të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.

